



Republika e Kosovës

Komuna e Drenas
Kuvendi Komunal



12 Nr 400-836/8 dt. 30.12. 2019

Bazuar ne nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Glllogocit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë, 27.12. 2019,miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2020-2024

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Glllogocit të miratoj Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit për Komunën e Glllogocit 2020-2024.

Neni 2

Pjesë përbërese e këtij propozim vendimi është Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit për Komunën e Glllogocit 2020-2024.

Neni 3

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit ka për qëllim të definojë veprimet për menaxhimin e cilësisë së ajrit përbrenda territorit të Komunës së Glllogocit për periudhën pesë vjeçare.

Neni 4

Me miratimin e këtij propozim vendimi për Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit përfshihen të gjitha aktivitetet të cilat paraqiten në PLVCA dhe janë të shtjelluara në mënyrë që të kenë përmbytjen e njëjtë duke filluar nga identifikimi i tyre, prioriteti i problemit, pastaj përcaktimi i bartësve kyq dhe mjeteve teknike dhe financiare që do të mundësonin zgjidhjen e problemeve të cilësisë së ajrit në nivel lokal.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.


Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .



Halil Halilaj

Kryetari i Kuvendit të Komunës



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration


Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i MMPH-së	
Nga: <i>për:</i>	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL, <i>Halilaj</i>	Datë: 23.01.2020
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për monitorim të komunave	Nr.020-1316/7
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendimin 12 Nr. 400-73618** për miratimin e planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit 2020 - 2024, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për :	Adriana Hoxhiq, Ministre në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Fatmir Matoshi, Ministër i MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së	
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor	Data: 13 / 01 / 2020
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Sabriqe Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

E nderuar Ministre,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 12 Nr.400-73618 për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2020-2024, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glogocit

I miratuar me datë: 27.12.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 31.12. 2019

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 06.01.2020

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.